

# Anketa e Buxhetit të Familjes

## 2016

**Tiranë, më 30 Tetor 2017:** Në vitin 2016, shpenzimet mesatare mujore për konsum<sup>1</sup> të NjEF të përbëra mesatarisht nga 3,7 persona, janë 73.143 lekë. Totali i shpenzimeve për konsum është 56,1 miliardë lekë në muaj për 768.311 familje. Shpenzimet mesatare për konsum të një individi vlerësohet të jenë 19.591 lekë në muaj nga të cilat: 8.861 lekë për konsum ushqimor dhe 10.730 lekë për konsum jo-ushqimor.

Vlerësimi i shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF, në vitin 2016 është 4,2 % më i lartë se në vitin 2015. Rritja e çmimeve të konsumit regjistruar në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015, është 1,3 %.

Uljen më të madhe të shpenzimeve mesatare për konsum mujor në vitin 2016, a ka shënuar grupi “Ushqim dhe pije jo-alkoolike” me 3,5 pikë përqindje krahasuar me 2015, ndërsa rritja më e madhe është regjistruar në grupin “Arsim” me 2,3 pikë përqindje.

**Tab.1 Struktura e shpenzimeve të konsumit të NjEF**

| Grupet kryesore të konsumit                                      | ABF 2015      |              | ABF 2016      |              |
|--|---------------|--------------|---------------|--------------|
|  | Vlera në Lekë | %            | Vlera në Lekë | %            |
| Ushqim dhe pije jo-alkoolike                                     | 34.489        | 48,7         | 33.083        | 45,2         |
| Pije alkoolike dhe duhan   | 2.507         | 3,5          | 2.507         | 3,4          |
| Veshje dhe këpucë  | 3.449         | 4,9          | 3.532         | 4,8          |
| Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar  | 7.318         | 10,3         | 7.477         | 10,2         |
| Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës | 3.378         | 4,8          | 3.662         | 5,0          |
| Shëndet  | 2.533         | 3,6          | 2.519         | 3,4          |
| Transport  | 4.796         | 6,8          | 4.609         | 6,3          |
| Komunikim  | 2.095         | 3,0          | 2.392         | 3,3          |
| Argëtim dhe kulturë  | 2.082         | 2,9          | 2.173         | 3,0          |
| Arsim  | 1.505         | 2,1          | 3.207         | 4,4          |
| Restorante dhe hotele  | 2.537         | 3,6          | 3.253         | 4,4          |
| Të tjera mallra dhe shërbime                                     | 4.076         | 5,8          | 4.729         | 6,5          |
| <b>Shpenzimet mesatare gjithsej</b>                              | <b>70.766</b> | <b>100,0</b> | <b>73.143</b> | <b>100,0</b> |


<sup>1</sup> Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF janë shpenzimet që kryen mesatarisht një NjEF gjithsej në Shqipëri, të cilat sillen me bazë mujore pasi mbledhen nga anketa përgjatë gjithë vitit. Në vijim do të referohemi shkurtimisht “shpenzimet mesatare mujore për konsum” me termin “shpenzime për konsum”.

Struktura e shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF sipas 12 grupeve kryesore të konsumit<sup>2</sup> tregon se grupi “Ushqime dhe pije jo-alkoolike” i cili ka peshën kryesore në buxhetin familjar me 45,2 %, rezulton me ulje 3,5 pikë përqindje, krahasuar me vitin e kaluar. Nëngrupet që zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim, janë “qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë”, 18,1 %, “bukë dhe drithëra” dhe “mish dhe nënprodukte” 17,5 %, ndjekur nga “perimet”, 13,9 % dhe “frutat” 8,0 %.

Shpenzimet për grupin “Pije alkoolike dhe duhan”, përbëjnë 3,4 % të buxhetit, në ulje me 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Nëngrupi “duhani” zë peshën kryesore me 62,6 %.

Grupi “Restorante dhe hotele”, që përfaqëson konsumin jashtë shtëpisë, përbën 4,4 % të buxhetit të NjEF, i cili regjistron një rritje me 0,8 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar. Brenda grupit, përqindjet e shpenzimeve për restorante përbëjnë pjesën më të madhe, 88,5 %, ndërsa shpenzimet për hotele vetëm 11,5 %.

**Fig.1 Struktura e shpenzimeve për konsum, 2016**



<sup>2</sup> Për më shumë detaje lidhur me përmbajtjen e grupeve kryesore të konsumit, shih Aneks.1 në seksionin “Metodologji dhe Përkufizime”.

Shpenzimet për grupin “Veshje dhe këpucë”, zënë 4,8 % të buxhetit total të cilat regjistrojnë ulje prej 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Nëngrupi “veshjet” zë peshën më të madhe në krahasim me nëngrupin “këpucë dhe të ngjashme” me një peshë prej 68,6 %.

Grupi i shpenzimeve për banesën, me shpenzimet për energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira të paguar dhe riparime të vogla zë 10,2 % të totalit të buxhetit familjar duke shënuar ulje prej 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin e mëparshëm. Rreth 50,3 % e këtyre shpenzimeve shkojnë për pagesën e energjisë elektrike dhe 17,3 % për përdorimin e lëndëve të tjera si gaz, naftë, dru zjarri etj. Shpenzimet që shkojnë për nëngrupin “qira e paguar”, kanë një peshë prej 14,1 %, me NjEF që deklarojnë shpenzime për pagesën e qirasë 6,3 %.

Shpenzimet për grupin “Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtja e tyre” zënë 5,0 % në strukturën e shpenzimeve mesatare mujore. Këto shpenzime regjistrojnë rritje prej 0,2 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar. Peshën më të madhe në grup e zënë artikujt shtëpiakë jo-afatgjatë, 70,6 %.

Përqindja e buxheti të NjEF për grupin “Shëndet”, zë një peshë prej 3,4 % duke shënuar ulje prej 0,2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Peshën më të madhe e zë blerja e medikamenteve me rreth 75,4 % ndërsa pjesa tjetër shkon për kujdes shëndetësor.

Shpenzimet për arsim, të cilat zënë 4,4 % të buxhetit gjithsej kanë pësuar rritje prej 2,3 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar. Peshën më të madhe e zënë pagesat në lidhje me kategorinë “Master (niveli i parë dhe i dytë)”, 68,3 %.

Grupi “Komunikim”, zë një peshë prej 3,3 % dhe shënon rritje prej 0,3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Pothuajse të gjitha shpenzimet e kryera nga NjEF i përkasin nëngrupit “shërbime telefonike”, duke zënë 98,4 % brenda grupit ndërsa pjesën tjetër e zë nëngrupi “shërbime postare”.


Shpenzimet e bëra në grupin “Transport” në vitin 2016 zënë 6,3 % të buxhetit gjithsej me ulje prej 0,5 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar. Peshën më të madhe brenda këtij grupi e përbëjnë “shpenzimet për karburantë dhe lubrifikantë”, 58,1 % ndjekur nga shpenzimet për “shërbim transporti” 22,1 %. Në nëngrupin “shërbim transporti” që përfshin transportin rrugor, ajror, detar dhe lumor, pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për transport rrugor, 76,0 % të nëngrupit.

Shpenzimet për grupin “Të tjera mallra dhe shërbime” zënë një peshë prej 6,5 % të buxhetit total, të cilat regjistrojnë rritje me 0,7 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Peshën më të madhe në këtë grup e zë nëngrupi “artikuj dhe produkte për kujdes personal” me 47,1 %. Shpenzimet e tjera në këtë grup shkojnë për nëngrupet “shpenzime të jashtëzakonshme” të kryera nga NjEF në raste ceremonish dhe festash, “pagesat për shërbime të ndryshme financiare private” dhe “sigurimet”.

**Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve, 2015 - 2016**

Në vitin 2016, qarku i Tiranës paraqet shpenzimet mesatare më të larta mujore për konsum. Një NjEF në qarkun e Tiranës shpenzon për konsum mesatarisht 85.344 lekë në muaj. Qarqet që paraqesin shpenzimet mesatare më të larta për konsum pas qarkut të Tiranës, janë Durrësi dhe Shkodra me shpenzime mesatare mujore për konsum përkatësisht 77.933 dhe 75.503 lekë në muaj për NjEF. Qarqet me nivel më të ulët të shpenzimeve mesatare mujore për konsum janë qarku i Gjirokastrës dhe i Elbasanit përkatësisht me 57.068 dhe 57.290 lekë në muaj për NjEF. Shpenzimet mesatare për konsum sipas qarqeve kanë ndryshuar gjatë periudhës 2015 – 2016. Rritjen më të madhe të shpenzimeve e paraqet qarku i Vlorës me 15,0 % ndjekur nga qarku i Dibrës me 12,4 %. Qarku që ka pësuar uljen më të madhe të shpenzimeve për konsum është Gjirokastra me 23,9 %.

**Fig.2 Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF sipas qarqeve**



Në vitin 2016, numri mesatar i anëtarëve të NjEF është 3,7 nga 3,8 që ishte në 2015. Qarku që ka numër më të madh të anëtarëve të NjEF është Kukësi, 5,2 anëtarë ndërsa Vlora dhe Gjirokastra kanë numrin më të vogël të anëtarëve në përbërjen e NjEF, 3,4 anëtarë.

**Tab.2 Madhësia mesatare e NjEF sipas qarqeve, 2016**

| Qarku                    | Berat | Dibër | Durrës | Elbasan | Fier | Gjirokastrë | Korçë | Kukës | Lezhë | Shkodër | Tiranë | Vlorë | Shqipëri |
|--------------------------|-------|-------|--------|---------|------|-------------|-------|-------|-------|---------|--------|-------|----------|
| Madhësia mesatare e NjEF | 3,5   | 4,9   | 3,8    | 3,9     | 3,6  | 3,4         | 3,5   | 5,2   | 4,0   | 3,9     | 3,6    | 3,4   | 3,7      |

### Shpërndarja e shpenzimeve për konsum sipas decileve dhe raporti 10/90, 2016

Shpërndarja e nivelit të shpenzimeve për konsum sipas decileve<sup>3</sup> tregon se 90 % e NjEF shpenzon 78,3 % të vlerës së konsumit gjithsej, me një mesatare të shpenzimeve për konsum prej 63.609 Lekë në muaj. Nga ana tjetër 10 % e NjEF shpenzon 21,7 % të konsumit gjithsej, me një shpenzim mesatar prej 158.946 Lekë në muaj. Shpenzimet mesatare për konsum të 10 % të NjEF me shpenzime më të larta janë 2,5 herë më shumë se ato të 90 % tjetër të NjEF.

Konsumi për frymë, i 90 % të NjEF me shpenzimet më të ulëta janë mesatarisht 18.119 Lekë në muaj, ndërsa 10 % i NjEF me shpenzimet më të larta, janë mesatarisht 62.562 Lekë në muaj për frymë. Raporti i decileve 10/90 është 3,5 herë më i madh në favor të 10% të NjEF.

Shpenzimet mesatare për konsum të NjEF tregojnë se në vitin 2016, ka pasur një rritje më të madhe të shpenzimeve të 10 përqindëshit të NjEF me shpenzimet më të larta (14,6 %) në krahasim me rritjen e shpenzimeve mesatare për konsum të 90 përqindëshit tjetër (0,6 %) në krahasim me 2015. Si rrjedhim, raporti i decileve në 2016, për këtë tregues, paraqet një rritje të pabarazisë nga 2,2 në 2,5, krahasuar me 2015.

**Tab. 3 Shpenzimet mesatare mujore për konsum për NjEF dhe Raporti i decileve 10/90**

|   | 2015                                    |                          | 2016                                    |                          |
|---|---|--------------------------|---|--------------------------|
|   | Shpenzimet mesatare për konsum për NjEF | Madhësia mesatare e NjEF | Shpenzimet mesatare për konsum për NjEF | Madhësia mesatare e NjEF |
| 10 % e NjEF (me shpenzimet më të larta) | 138.711                                 | 2,4                      | 158.946                                 | 2,6                      |
| 90 % e NjEF të tjera                    | 63.221                                  | 3,9                      | 63.609                                  | 3,9                      |
| Konsumi mesatar                         | 70.766                                  | 3,8                      | 73.143                                  | 3,7                      |
| Raporti 10/90                           | 2,2                                     |                          | 2,5                                     |                          |

<sup>3</sup> Decilja përcaktohet si një nga dhjetë grupet e barabarta në të cilat janë ndarë vlerat statistikore të renditura të një variabli, në këtë rast shpenzimet e konsumit.

Shpenzimet mesatare të konsumit për frymë, ruajnë të njëjtën tendencë të rritjes së shpenzimeve nga të dy shtresat e popullsisë që i referohen 10 dhe 90 përqind të NjEF. Edhe në rastin e shpenzimeve për frymë, në vitin 2016, raporti i decileve 10/90, tregon për një rritje të pabarazisë nga 3,3 në 3,5, krahasuar me vitin 2015.

**Tab. 4 Shpenzimet mesatare mujore për konsum për frymë dhe Raporti i decileve 10/90**

|   | 2015                                     |                          | 2016                                     |                          |
|---|--|--------------------------|--|--------------------------|
|   | Shpenzimet mesatare për konsum për frymë | Madhësia mesatare e NjEF | Shpenzimet mesatare për konsum për frymë | Madhësia mesatare e NjEF |
| 10 % e NjEF (me shpenzimet më të larta) | 58.582                                   | 2,4                      | 62.562                                   | 2,6                      |
| 90 % e NjEF të tjera                    | 17.687                                   | 3,9                      | 18.119                                   | 3,9                      |
| Konsumi mesatar                         | 21.775                                   | 3,8                      | 22.563                                   | 3,7                      |
| Raporti 10/90                           | 3,3                                      |                          | 3,5                                      |                          |

**Shpërndarja e shpenzimeve mesatare të konsumit sipas tipit të NjEF, 2016**

Në 2016, NjEF e përbëra nga një person i vetëm me fëmijë në varësi shpenzojnë më shumë për ushqim, krahasuar me tipet e tjera, 52,2 %. Shpenzimet më të larta për transport paraqiten në NjEF e përbëra nga dy të rritur me fëmijë dhe tre ose më shumë të rritur pa fëmijë, 7,0 %. Shpenzimet më të larta për arsim regjistrohen në NjEF e përbëra nga tre ose më shumë të rritur me fëmijë në varësi, 6,9 %.

**Tab.5 Shpërndarja e shpenzimeve të konsumit sipas tipit të NjEF në %, 2016**

| Grupet kryesore të konsumit  | Tipi i Njesisë Ekonomike Familjare |                                    |                        |                        |                                      |                                      | Gjithsej     |
|--|------------------------------------|------------------------------------|------------------------|------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------|
|  | Person i vetëm                     | Person i vetëm me fëmijë në varësi | Dy të rritur pa fëmijë | Dy të rritur me fëmijë | Tre ose më shumë të rritur pa fëmijë | Tre ose më shumë të rritur me fëmijë |              |
| Ushqim dhe pije jo-alkoolike                                       | 51,3                               | 52,2                               | 49,5                   | 45,4                   | 41,5                                 | 45,3                                 | 45,2         |
| Pije alkoolike, duhan  | 2,2                                | 1,9                                | 3,5                    | 3,0                    | 3,9                                  | 3,4                                  | 3,4          |
| Veshje dhe këpucë  | 2,9                                | 5,1                                | 4,1                    | 4,8                    | 5,1                                  | 5,1                                  | 4,8          |
| Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar      | 14,4                               | 12,8                               | 12,2                   | 11,4                   | 9,5                                  | 8,8                                  | 10,2         |
| Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës | 5,2                                | 4,4                                | 5,9                    | 4,8                    | 4,9                                  | 4,9                                  | 5,0          |
| Shëndet  | 5,7                                | 1,9                                | 5,2                    | 2,6                    | 2,9                                  | 3,4                                  | 3,4          |
| Transport  | 2,5                                | 4,2                                | 4,3                    | 7,0                    | 7,0                                  | 6,8                                  | 6,3          |
| Komunikim  | 3,6                                | 3,4                                | 3,6                    | 3,2                    | 3,4                                  | 3,0                                  | 3,3          |
| Argëtim dhe kulturë  | 2,5                                | 3,7                                | 2,6                    | 3,4                    | 3,1                                  | 2,9                                  | 3,0          |
| Arsim  | -                                  | 3,3                                | 0,2                    | 3,0                    | 6,9                                  | 5,5                                  | 4,4          |
| Restorante dhe hotele  | 3,7                                | 1,8                                | 3,4                    | 4,3                    | 5,6                                  | 4,2                                  | 4,4          |
| Të tjera mallra dhe shërbime                                       | 5,9                                | 5,3                                | 5,7                    | 7,1                    | 6,3                                  | 6,7                                  | 6,5          |
| <b>Shpenzimet për konsum gjithsej</b>                              | <b>100,0</b>                       | <b>100,0</b>                       | <b>100,0</b>           | <b>100,0</b>           | <b>100,0</b>                         | <b>100,0</b>                         | <b>100,0</b> |

# Metodologjia

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësisve ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri. Rezultatet e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të NjEF si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve.

Anketa e Buxhetit të Familjes u krye për herë të parë në vitet 1999-2000 dhe ishte përfaqësuese vetëm për zonat urbane, për të vazhduar më pas në vitet 2006-2007, 2008-2009<sup>4</sup> dhe që nga viti 2014 e vazhdueshme. Nga viti 2006-2007 anketa është gjithë-përfshirëse për të gjithë territorin e Shqipërisë duke përfshirë zonat urbane dhe rurale si dhe me përfaqësim në nivel qarku.

Anketa e Buxhetit të Familjes 2016 u krye nga INSTAT përgjatë gjithë vitit, me një kampion prej 9.024 NjEF. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan rreth 7.353 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 81,5 %.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censusit të homogjenizuara<sup>5</sup>, me probabilitetet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censusit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 12 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme duke siguruar një përfaqësim edhe në nivel qarku. Totali i NjEF të kampionuara u nda në 4 nën-kampione tre-mujore të cilët u shpërndanë gjeografikisht në mënyrë homogjene gjatë gjithë vitit, për të bërë të mundur pasqyrimin e ndryshimeve stinore. Si rrjedhim, janë anketuar çdo muaj rreth 752 NjEF të shpërndara njëtrajtësisht në të gjitha zonat e zgjedhura, për të siguruar përfaqësimin e çdo zone në të gjithë muajt e vitit.

Mbledhja e të dhënave bazohet në dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit:

- Plotësimi i një ditari nga ana e NjEF për 14 ditë në vazhdim ku regjistrohen shpenzimet për blerje produktesh/shërbimesh të konsumit të gjerë si dhe, sa herë që plotësohen kushtet, plotësimi i një ditari të veçantë për autokonsum ku familja regjistron vetëm produktet e prodhuara dhe të konsumuara gjatë 14 ditëve te referencës, vlerësuar me çmimin që do të kishte paguar për t'i blerë në dyqanin më të afërt.
- Kryerja e një interviste direkte nga anketuesit nëpërmjet një pyetësi ku përfshihen pyetje mbi shpenzimet me vlerë më të madhe dhe me frekuencë blerjeje më të rrallë, të grupuara dhe të ndara sipas temave të

<sup>4</sup> Periudha e kryerjes në terren ishte: tetor 2006 - shtator 2007 dhe nëntor 2008 - tetor 2009.

<sup>5</sup> Homogjene nënkupton që çdo zonë Censusi ka të njëjtat karakteristika në shpenzimet e konsumit midis NjEF dhe madhësia për secilën PSU ka përafërsisht të njëjtin numër NjEF apo individësh.

veçanta. Në të njëjtin pyetësor janë përfshirë edhe pyetjet mbi të dhënat socio-demografike të anëtarëve të NjEF që do të shërbejnë gjatë analizës së buxhetit familjar sipas tipologjive të NjEF.

**Përkufizime:**

**Shpenzimet për konsum të NjEF** përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NjEF dhe individëve me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.

**Grupet kryesore të konsumit** janë përcaktuar sipas Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), 2012.

**Periudha e referencës** është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.

**Një njësi ekonomike familjare (NjEF)** i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

**Kryefamiljari** është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NjEF). Nëse anëtarët e NjEF nuk e përcaktojnë vetë këtë person, normalisht do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NjEF.

**Fëmijë** është konsideruar çdo individ nën moshën 18 vjeç.



## Aneksi 1 - Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)

| Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)                |  |
|--|--|
| KATEGORITË   | Disa detaje përsa i perket zërave në çdo kategori të cilat shërbejnë vetëm për konsum familjar.  |
| 1 - USHQIME DHE PIJE JO-ALKOOLIKE  | Produktet ushqimore të klasifikuara këtu janë ato të blera dhe të prodhuara për konsum në shtëpi.  |
|  | Grurë, Misër, Oriz, Miell dhe nënprodukte të tij, Bukë, Mish, Peshk, Produkte të tjera deti, Vaj, Fruta, Perime, Qumësht, Djathë, Gjalp, Gjizë, Vezë, ujë mineral dhe me gaz, lengje frutash, Kafë, Caj, Mjalt, Produkte Sheqeri, Te gjitha produktet e kesaj kategorie te prodhuara nga vete familja etj.   |
| 2 - PIJE ALKOOLIKE DHE DUHAN   | Pijet alkoolike të klasifikuara këtu janë ato që zakonisht blihen për konsum në shtëpi.  |
|  | Verë, Birrë, Raki, Whisky, Të gjitha llojet e Likemave, Uzo dhe pije të tjera gjallëruese Duhan, Cigare, Puro, Letër cigare, Filtër etj.   |
| 3 - VESHJE DHE KËPUCË  | Në këtë zë përfshihen veshje, këpucë, të reja apo të përdorura, materiale për veshje, dhe riparimi i tyre, etj.  |
|  | Veshje për burra, gra, fëmijë (3 deri 13 vjeç) dhe foshnja (0 deri 2 vjeç), qofshin të gatshme ose të bëra me porosi, në të gjitha materialet ( përfshirë lëkure, gëzof, plastike dhe gome), të përditëshme, për sporte ose për punë: pardesy, mantele shiu, bluza, xhupa, xhaketa, pantallona, kostume, fustane, funde, etj. Këmisha, bluza, pulovra, bluza pas trupit, pantallona të shkurtra, roba banje, tuta, kostume vrapimi, geta, etj. Jelek, të brendëshme, çorape, streçe, geta, sutiena, funde me palë, të brendëshme me tantellë, fustane nate, breza, korse, çorape të thurura, etj. Bizhama , bluza nate, robdishane, kostume banje, xhaketa për shtëpi, etj. Veshje për fëmijë dhe çorape të thurura për fëmijë |
| 4 - STREHIMI, UJI, ENERGJIA ELEKTRIKE DHE LËNDE TË TJERA DJEGËSE         | Në këtë zë përfshihen: Qiraja e paguar (si shpenzim i kryer efektivisht për marrjen e ambienteve të banimit me qira nga ana e NJEF), mirëmbajtja dhe riparimi i banesës, materiale për riparim, pagesa për energji elektrike: ujë, gaz, hecje plerash, dhe të gjitha pagesat që kanë lidhje me banesën e familjes etj.   |
| 5 - MOBILJE, PAJISJE PËR SHTËPINË DHE MIRËMBAJTJA E ZAKONSHME E SHTËPISË | Në këtë zë përfshihen: Krevate, sofa, divane, tavolina, karrige, bufe, komo dhe rafte librash, pajisjet e ndriçimit si abazhurë tavanesh, llampa standart, në formë globesh, dhe abazhurë komodinash , të gjitha llojet e tekstilëve për shtëpi, pajisje elektroshtëpiake, pajisje dhe vegla për kopshtin, tapete, riparimi i tyre, pagesa për kopshtar, guzhiniere, dado etj.   |
| 6 - SHËNDETI   | Ky grup mbulon ilaçet, protezat, makineritë dhe pajisjet mjekësore si dhe produkte të tjera të lidhura me mjekimin të blera nga individët, me dhe pa recetë, zakonisht nga furnizuesit e ilaçeve, aparatura dhe pajisje terapeutike, të gjitha llojet e shërbimeve mjekësore përfshirë dhe ato ambulatorë etj.   |
| 7 - TRANSPORTI   | Të gjitha llojet e makinave, të reja dhe të përdorura, taxi, Bileta avionësh, të gjitha llojet e biletave Naftë, Gas, Pjesë këmbimi dhe riparime, Garazhde, etj.   |
| 8 - KOMUNIKIMI   | Shërbime postare, të gjitha llojet e shërbimeve për komunikim, telefona, celularë, fax, internet etj.  |
| 9 - ARGËTIMI DHE KULTURA   | Në këtë zë përfshihen të gjitha llojet e pajisjeve audio-vizuale, Aparate marje, regjistrimi dhe riprodhimi të tingujve dhe filmave, Pajisjet e përpunimit të informacionit, Pajisje fotografike dhe kinematografike dhe instrumente optike, Të mira afatgjata për argëtim në ambientet e jashtme, Pajisjet kryesore për lojra dhe sport, Bileta, lojra fati , riparimi dhe mirëmbajtja e tyre etj.  |
| 10 - ARSIMI  | Kjo ndarje përfshin vetëm shërbimin e arsimit.   |
|  | Klasifikimi i shërbimeve të arsimit bazohet në kategoritë sipas niveleve të Klasifikimit Standart Ndërkombëtar të Arsimit (ISCED) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO).  |
|  | Përfshihen: Arsimit parashkollor dhe fillor, Arsimit 8/9 vjeçar dhe i mesëm, Arsimit parauniversitar, Arsimit i lartë, Arsimit i papërcaktuar në nivele (Kurse arsimit)  |
| 11 - RESTORANTE DHE HOTELE   | Në këtë zë përfshihen: Restorante, bare dhe të tjera si këto, Shërbimet e akomodimit, menca, etj. Përfshihen: shërbime të shpërndarjes së produkteve ushqimore (ushqime, meze, pije dhe pije freskuese) të ofruara nga restorantet, kafenet, bufetë, baret, etj. Hotele, motele, hane dhe shërbime të ngjashme akomodimi, Qendra pushimesh, vende për kamping, bujtina për të rinjtë dhe shërbime të ngjashme akomodimi, Shërbimet e akomodimit të institucioneve të tjera   |
| 12 – TË MIRA DHE SHËRBIME TË NDRYSHME                                    | Në këtë zë përfshihen: Sallone bukurie dhe institucione të kujdesit personal, Pajisje elektrike dhe jo-elektrike për kujdes personal, riparimi i pajisjeve për kujdes personal, Sende personale, Përkrahja sociale, Sigurimi, Shërbime financiare të specifikuar, Shërbime të tjera të paspecifikuara etj.   |